

Billushë Village of Prizren, pasqyra e lajmeve, KIC, 07.08.1998, FDH-29405.

Bashkim (Sami) Emini

(28.02.1976, shqiptar nga Vojnocit/Vojinovec, komuna e Shtimes/Štimlje, arsimtar i kulturës fizike, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Arsim (Sylejman) Bega

(1.03.1978, shqiptar nga Jezerci/Jezerce, komuna e Ferizajt/Uroševac, i papunë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Bashkimi u bë anëtar i UÇK-së pas mbarimit të studimeve, në muajin qershor të vitit 1998. Arsimi aderoi në UÇK në Shqipëri. Në datën **9.08.1998**, Bashkimi dhe Arsimi ishin në kuadrin e grupit të ushtarëve të UÇK-së, i cili e bartte një ngarkesë armatimesh nga Shqipëria në Kosovë. U ndeshën me kufitarët e Ushtrisë së Jugosllavisë në bjeshkën e *Pashtrikut/Paštrik*. Që të dy kanë gjetur vdekjen në këtë betejë. Pjesëtarët e UJ-së i kanë bartur trupat e tyre në morgun e spitalit në Prizren, dhe, më pas, i kanë varrosur në varrezat në afërsi të spitalit. Pas lufte, familjarët kanë mësuar për vendndodhjen e varreve të Bashkimit dhe Arsimit. Familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Bashkimit në varrezat e Vojnocit/Vojinovec. Arsimin, së pari, e rivarrosën në varrezat e Mallopolcit/Malopoljce [Shtime/Štimlje], dhe më pas, më 12.09.1999, në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Ferizaj/Uroševac.

Burimet: deklarata H.E, FDH-23596; N. Kra-sniqi, *Kohë...*, 271-272; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; fotografi, FDH-25070; SHF DUÇK, *Feniksët...*, 9, 50-52.

Adem (Selom) Berisha

(29.07.1963, shqiptar nga Buça/Buča, komuna e Dragashit/Dragaš, teknik bujqësor dhe bletar, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Ademi punonte në ndërmarrjen *Sharr Produkti* nga Dragashi/Dragaš deri në vitin 1990, kur e pushuan nga puna. Nga ky vit, ai merrej me bletari dhe bujqësi. Ma bashkëshorten Sheribanen i kishin vajzat Leonoren, Lindonen, Lumëbardhën dhe Fëllënzën, si dhe djalin Etnikun. Me ta në bashkësi familjare jetonin edhe nëna

e Ademit, Bahrije, dhe i vëllai Jahiri me familje. Ademi ka aderuar në UÇK në fillim të vitit 1998. Disa herë ka shkuar në Shqipëri për të transportuar armatime. Në datën 12.08.1998, policët serbë e ndalën Ademin dhe të emën në rrugë dhe i urdhëruan atij që të paraqitet ditën e ardhshme në stacionin e policisë në Dragash/Dragaš. Familjarët e këshillonin që mos t'i bindet urdhrat, por ai shkoi në mëngjesin tjetër [**12.08.1998**]. Me të u nis edhe miku dhe bashkëluf-tëtari i tij, Jetoni. Te vendi i quajtur *Tyrbja e Pllavës/Plavsko turbe* [Buçe/Buča], pranë tyre u ndalën dy makina me pjesëtarë të SSH në roba civile dhe i futën Ademin dhe Jetonin në njëren prej makinave. I çuan në Stacionin e Policisë në **Prizren**. I vendosën në dhoma të ndara. Që të dy u shkopitën dhe u keqtrajtuat rëndë. Ademi ishte alivanosur disa herë. Ishte i dëmtuar rëndë nga dajaku. Në datën 15.08.1998, e transferuan në gjendje të rëndë nga paraburgimi policor në spitalin e Prizrenit/Prizren. E ruanin tërë kohën dy policë në roba civile. Nga dita e arrestimit të Ademit, familja e tij nuk guxonte të largohej nga shtëpia. Pas tri ditësh, mësuan se Ademin në gjendje të rëndë e kishin transferuar në spital. E ëma Bahrije ka shkuar ditën tjetër [16.08.1998] në spital. Dy policë, të cilët e ruanin Ademin, e rrahën keq duke i thënë se ishte "e ëma e terroristit". Bahrija ka arritur fshehurazi që në dy ditët e ardhshme tu dërgonte mjekëve ilaçet për Ademit, si dhe të organizonte farefisën dhe miqtë për të dhënë gjak për të birin. Megjithatë, Ademi ndërroi jetë në mëngjesin e datës 19.08.1998. Po atë ditë, miqtë e familjes Berisha e kanë sjellë trupin e Ademit në fshat. Policia u ka dhënë afat prej dy orësh për të kryer varrimin. Ademin e kanë varrosur pasdite në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata J.B, FDH-37956; *Albanian Detainee Dies from Serb Police Torture*, pasqyra e lajmeve, 19.08.1998, FDH-29433; HRW, *Shkeljet...*, 70, FDH-31132.

Remzi (Bajram) Ademaj

(3.03.1952, shqiptar nga Zhuri/Žur, komuna e Prizrenit/Prizren, punëtor, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)